



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 590, datë 13.10.2021

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.202,
DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN
DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE,
SI DHE ÇDO NDËRHJRJE TJETËR NË FUNKSION
TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në pikën 2.2, shifra "... 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH ..." zëvendësohet me shifrën "... 1 375 821 704 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH ...".
 - b) Pas shkronjës "a", të pikës 2.2, shtohet shkronja "b", me këtë përmbajtje:

“b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 875 821 704 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim. Efekti financiar do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4775/1
DATË 14.10- 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

